



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**PROJEKTLIGJI PËR VETERANËT E USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS**

**DRAFT LAW ON VETERANS OF THE KOSOVO LIBERATION ARMY**

**NACRT ZAKONA O VETERANIMA OSLOBODILAČKE VOJSKE KOSOVA**

<p>Kuvendi i Republikës së Kosovës, Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Miraton:</p> <p style="text-align: center;"><b>LIGJ PËR VETERANËT E USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 1 Qëllimi</b></p> <p>Qëllimi i nxjerrjes së këtij ligji është përcaktimi i të drejtave në beneficione të Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së), të cilët, me sakrificën, angazhimin dhe kontributin e tyre të çmuar, në Luftën Çlirimtare të Kosovës, ishin faktorë vendimtarë për sjelljen e lirisë dhe pavarësisë për popullin e Kosovës.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 2 Fushëveprimi</b></p> <p>1. Me këtë ligj përcaktohen të drejtat në beneficione për Veteranët e UÇK-së dhe anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre, kriteret</p>	<p>The Assembly of the Republic of Kosovo, Pursuant to Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo, Approves:</p> <p style="text-align: center;"><b>LAW ON VETERANS OF THE KOSOVO LIBERATION ARMY</b></p> <p style="text-align: center;"><b>I. GENERAL PROVISIONS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 1 Purpose</b></p> <p>The purpose of the law is to define the benefits entitlements for the Veterans of the Kosovo Liberation Army (KLA), who with their precious sacrifice, commitment and contribution proved to be a crucial factor in bringing freedom and independence to the people of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 2 Scope</b></p> <p>1. The present Law defines benefit entitlements for KLA Veterans and immediate members of their families, qualification criteria for their</p>	<p>Skupština Republike Kosovo, Na osnovu člana 65 (1) Ustava Republike Kosovo, Usvaja:</p> <p style="text-align: center;"><b>ZAKON O VETERANIMA OSLOBODILAČKE VOJSKE KOSOVA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>I. OPŠTE ODREDBE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 1 Svrha</b></p> <p>Svrha donošenja ovog Zakona je utvrđivanje prava na beneficije veteranima Oslobodilačke vojske Kosova (OVK), koji su svojim požrtvovanjem, angažovanjem i dragocenim doprinosom u oslobodilačkoj borbi Kosova bili presudan faktor u donošenju slobode i nezavisnosti narodu Kosova.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 2 Delokrug važenja</b></p> <p>1. Ovim Zakonom utvrđuju se prava na beneficije veteranima OVK i njihovim članovima uže porodice, kriterijumi</p>
---	--	--

<p>e kualifikimit për njohjen dhe realizimin e tyre si dhe procedurat administrative për realizimin e këtyre të drejtave, siç është përcaktuar në nenin 12 (paragrafi 2) të Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre.</p> <p>2. Ky ligj nuk zbatohet ndaj kategorive tashmë të trajtuara dhe që përfitojnë beneficione në Ligjin nr. 04/L-054.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 3 Përkufizimet</b></p> <p>1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:</p> <p>1.1. <b>Lufta Çlirimtare e Kosovës (LÇK)</b> – është lufta e armatosur e popullit të Kosovës, e udhëhequr nga UÇK – ja, me qëllim të çlirimit të Kosovës dhe sjelljes së lirisë dhe pavarësisë për popullin e Kosovës, me karakter mbrojtës dhe çlirimtar, e drejtuar ekskluzivisht kundër forcave ushtarake, policore dhe administratës okupuese të Serbisë në Kosovë;</p> <p>1.2. <b>Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK)</b> – Formacion ushtarak i armatosur dhe i organizuar në baza vullnetare me</p>	<p>recognition and implementation as well as administrative procedures to implement these rights, as defined in Article 12 (paragraph 20 of the Law No. 04/L-054 on the Status and the Rights of Martyrs, Invalids, Veterans, Members of Kosovo Liberation Army, Civilian Victims and their Families.</p> <p>2. The present Law shall not be applicable to categories that are already benefiting from the Law No. 04/L-054.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 3 Definitions</b></p> <p>1. Terms used in the present Law shall have the following meaning:</p> <p>1.1. <b>Kosovo Liberation War (KLW)</b> – is the armed resistance of the people of Kosovo led by KLA with the aim of liberating Kosovo and bringing freedom and independence to the people of Kosovo, with a defending and liberating character, and addressed exclusively against Serbia’s military and police forces as well as its occupying administration in Kosovo;</p> <p>1.2. <b>Kosovo Liberation Army (KLA)</b> – the voluntary armed and organized military formation with distinctive uniforms and</p>	<p>kvalifikacije za njihovo priznanje i realizaciju kao i upravni postupci za ostvarenje tih prava, kao što je utvrđeno u članu 12 stav 2 Zakona br. 04/L-054 o statusu i pravima palih boraca, invalida i veterana učesnika Oslobođilačke vojske Kosova, civilnih žrtava i njihovih porodica..</p> <p>2. Ovaj Zakon ne primenjuje se na već postojeće kategorije koje su uređene i uživaju beneficije na osnovu Zakona br. 04/L-054.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 3 Značenja izraza</b></p> <p>1. Izrazi korišćeno u ovom Zakonu imaju sledeća značenja:</p> <p>1.1. <b>Oslobodilačka borba Kosova (OBK)</b> – jeste oružana borba kosovskog naroda, koju je predvodila OVK, u cilju oslobođenja Kosova i donošenja slobode i nezavisnosti narodu Kosova, odbrambenog i oslobodilačkog karaktera, uperena isključivo protiv srpskih okupatorskih vojnih, policijskih i administrativnih snaga na Kosovu;</p> <p>1.2. <b>Oslobodilačka vojska Kosova (OVK)</b> – naoružana i organizovana vojna formacija zasnovana na</p>
---	--	--

<p>uniforma dhe shenja dalluese, me njësi organizative dhe zinxhir komandues të drejtuar nga Shtabi i Përgjithshëm, nën kontrollin civil të udhëheqjes politike, me mision të qartë për mbrojtjen e popullit të Kosovës dhe çlirimin e vendit nga forcat ushtarake, policore dhe administrata okupuese e Serbisë në Kosovë;</p> <p>1.3. <b>Veteran i UÇK-së</b> – siç është përcaktuar në Nenin 3 (paragrafi 1.9) të Ligjit nr. 04/L-054, është qytetari i Kosovës dhe shtetasi i huaj i cili është radhitur në radhët e UÇK-së dhe është regjistruar si ushtar nga komandat (shtabet e zonave operative të UÇK-së), përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, gjatë periudhës 1997-1999, dhe kategorizohen sipas kritereve të përcaktuara në këtë ligj;</p> <p>1.4. <b>Veteran Luftëtarë i UÇK-së</b>, është: qytetari i Kosovës dhe shtetasi i huaj i cili është radhitur në radhët e UÇK-së dhe është regjistruar, deri më datën 12 qershor 1999, si ushtar i armatosur dhe i uniformuar, nga komandat, shtabet e zonave operative të UÇK-së, përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, dhe i cili ka qenë aktiv në luftë deri në përfundimin e luftës;</p>	<p>signs, with its organizational units and chain of command led by the General Headquarters, under the civilian control of the political leadership, with the clear mission to defend the people of Kosovo and liberation of the country by military forces, police and occupied administration by Serbia in Kosovo;</p> <p>1.3. <b>KLA Veteran</b> - as defined in Article 3 (paragraph 1.9) of the Law No. 04/L-054 is a citizen of Kosovo and a foreigner, who joined KLA formations and is registered as soldier by commands, (KLA operation zones' headquarters), respectively KLA General Headquarters, during the period 1997-1999, and shall be categorized according to the criteria set forth in the Law;</p> <p>1.4. <b>KLA Member Veteran</b> is any person, who with a decision or any other act, was assigned to perform concrete tasks in support of political, logistical, financial and other tasks assumed by commanders of the units, KLA zone headquarters, respectively KLA General Headquarters, and who was active in the war until the end of it;</p>	<p>dobrovoljnosti i sa karakterističnim uniformama i obeležjima, sa organizacijskim jedinicama i komandnim lancem kojim rukovodi Glavni štab, pod civilnom kontrolom političkih rukovodilaca, sa jasnim zadatkom da zaštiti kosovski narod od okupatorskog i da oslobodi zemlju od vojnih, policijskih snaga i od okupacione uparve Srbije na Kosovu;</p> <p>1.3. <b>Veteran OVK-a „a ko što je utvrđeno u članz 3 stav 1.9 Zakona br. 04/L-</b> je građanin Kosova I strani državljanin koji je stao uz redove OVK-a i registrovan kao vojnik od strane komandi( štabova operativnih zona OVK.a tokom perioda 1997-1999,i kategorizuju se prema kriterijumima definisanih u ovom zakonu</p> <p>1.4. <b>Ratni veteran OVK je</b> građanin Kosova i strani državljanin koji je primljen u redove OVK i koga su pre 12. Juna 1999. godine u vojsci registrovali kao naoružanog i uniformisanog vojnika komandat, štab operative zone OVK odnosno Glavni štab OVK, i koji je bio ratno aktivan do kraja rata;</p>
--	--	--

<p>1.5. <b>Veteran Pjesëtarë i UÇK së</b> është çdo person i cili me vendim apo akt tjetër është caktuar të kryej detyra konkrete në mbështetje politike, logjistike, financiare dhe detyra të tjera të marra nga komandantët e njësive, shtabeve dhe zonave të UÇK- së, përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK- së, gjatë periudhës 1997- 1999;</p> <p>1.6. <b>Veteran Pjesëmarrës i Luftës së UÇK-së</b> konsiderohet ushtari i cili është radhitur në radhët e UÇK-së, ka qenë i angazhuar në mënyrë aktive për të kontribuar në luftë, por për arsye të ndryshme i ka lëshuar radhët e UÇK- së, para përfundimit të luftës;</p> <p>1.7. <b>SHP</b> - Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së;</p> <p>1.8. <b>ZÇKL</b> - Zyra për çështjet e kategorive të dala nga lufta;</p> <p>1.9. <b>SHFD</b> - Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së;</p> <p>1.10. <b>OVL</b> - Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së;</p> <p>1.11. <b>SHIL</b> - Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së;</p> <p>1.12. <b>Komisioni</b> - Komisioni qeveritar</p>	<p>1.5. <b>KLA Member Veteran</b> is any person, who with a decision or any other act, was assigned to perform concrete tasks in support of political, logistical, financial and other tasks assumed by commanders of the units, KLA zone headquarters and KLA General Headquarters, during the period 1997 – 1999;</p> <p>1.6. <b>Veteran Participant in the KLA War</b> shall be considered any soldier enlisted with KLA formations, that was actively engaged to contribute in the war, but who for various reasons abandoned KLA formations before the end of the war;</p> <p>1.7. <b>GH</b> - KLA General Headquarters;</p> <p>1.8. <b>OAWC</b> - Office for Affairs related to Categories deriving from the War;</p> <p>1.9. <b>AFM</b> - Association of Families of KLA Martyrs;</p> <p>1.10. <b>OWV</b> - Organization of KLA War Veterans;</p> <p>1.11. <b>AWI</b> - Association of KLA War Invalids;</p> <p>1.12. <b>Commission</b> – Government</p>	<p>1.5. <b>Veteran pripadnik OVK</b> je svako lice kome je odlukom ili drugim aktom bilo naloženo da obavlja konkretne zadatke kao političku, logističku ili finansijsku podršku, ili druge zadatke dobijene od strane komandanata jedinica, štabova i zona OVK, odnosno Glavnog štaba OVK, u periodu od 1997- 1999. Godine;</p> <p>1.6. <b>Veteranom Učesnikom rata OVK</b> smatra se vojnik koji je primljen u redove OVK, koji je bio aktivno angažovan u doprinosu borbi, ali je iz različitih razloga napustio redove OVK pre završetka rata;</p> <p>1.7. <b>GŠ</b> - Glavni štab OVK;</p> <p>1.8. <b>KPKR</b> - Kancelarija za pitanja kategorija proisteklih iz rata;</p> <p>1.9. <b>UPPB</b> - Udruženje porodica palih boraca OVK;</p> <p>1.10. <b>ORV</b> - Organizacija ratnih veterana OVK;</p> <p>1.11. <b>URI</b> - Udruženje ratnih invalida OVK;</p> <p>1.12. <b>Komisija</b> – Vladina Komisija za</p>
---	---	---

<p>për njohjen dhe verifikimin e statusit të veteranit UÇK-së dhe kategorive tjera i themeluar sipas Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre;</p> <p>1.13. <b>Ministria</b> - Ministria përkatëse për punë dhe mirëqenie sociale;</p> <p>1.14. <b>Pensioni i Veteranit</b>- pagesa e rregullt mujore që i bëhet veteranit gjatë tërë jetës;</p> <p>1.15. <b>Anëtarë të familjes së ngushtë</b> në kuptim të këtij ligji janë: bashkëshorti, bashkëshortja, fëmijët, fëmijët jashtëmartesor, fëmijët e adoptuar (birësuar), prindërit, njerka, njerku, thjeshtri, thjeshtira si dhe bashkëshorti/bashkëshortja jashtëmartesore:</p> <p>1.15.1. statusi i bashkësisë jashtëmartesore sipas këtij ligji përcaktohet me procedurë gjyqësore jashtë kontestimore.</p> <p>1.16. <b>Pensioni i trashëgimtarit</b> - pagesa e rregullt mujore për trashëgimtarët e veteranit;</p> <p>1.17. <b>Pensioni i zakonshëm publik</b> - pensionin nga fondi publik i pensionimit</p>	<p>Commission for the Recognition and Verification of the Status of KLA Veteran and other categories established by the Law No. 04/L-054 on the Status and Rights of Martyrs, Invalids, Veterans, Members of Kosovo Liberation Army, Civilian Victims and their Families;</p> <p>1.13. <b>Ministry</b> – Ministry of Labour and Social Welfare;</p> <p>1.14. <b>Veteran Pension</b> – regular monthly payment executed to a veteran for life;</p> <p>1.15. <b>Members of close family</b> in terms of this law are: husband, wife, children, children out of wedlock, the adopted children (foster), parents, step father, step mother, stepchild and extramarital husband/wife;</p> <p>1.15.1. the status of the out-of-marriage community according to this Law is determined by out contentious judicial procedure.</p> <p>1.16. <b>Inheritor’s pension</b> - regular monthly payment for veterans’ inheritor;</p> <p>1.17. <b>Common public pension</b> – pension from the public retirement fund paid by the</p>	<p>priznavanje i verifikaciju statusa veterana OVK i drugih kategorija zasnovanih na Zakonu br. 04/L-054 o statusu i pravima palih boraca, invalida i veterana učesnika Oslobođilačke vojske Kosova, civilnih žrtava i njihovih porodica;</p> <p>1.13. <b>Ministarstvo</b> - Ministarstvo nadležno za rad i socijalno staranje;</p> <p>1.14. <b>Penzija veterana</b> - redovna mesečna plaćanja koja se isplaćuju veteranima doživotno;</p> <p>1.15. <b>Članovi uže porodice</b> - u smislu ovog Zakona su : suprug, supruga, deca, van-bračna deca, usvojena deca, roditelji, očuh, maćeha, pastarak, pastorka, kao i vanbračni suprug/a.</p> <p>1.15.1 Status vanbračne zajednice prema ovom Zakonu utvrđuje se vanparničnim sudskim postupkom ;</p> <p>1.16. <b>Penzija naslednika</b> - redovna mesečna plaćanja za naslednike veterana;</p> <p>1.17. <b>Redovna javna penzija</b> - penzija iz javnog penzionog fonda koju Vlada</p>
--	---	---

<p>që Qeveria e Kosovës u paguan të gjithë qytetarëve me të drejtë pensioni, nëse është përcaktuar dhe në atë masë sa përcaktohet sipas ligjit në fuqi;</p> <p>1.18. <b>Ligji nr. 04/L-054</b> - Ligji nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 30 / 31 dhjetor 2011, Prishtinë).</p> <p><b>II. KATEGORIZIMI I VETERANËVE TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 4</b> <b>Kategorizimi i veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës</b></p> <p>1. Duke vlerësuar lartë sakrificën dhe vuajtjet e popullit të Kosovës, në Luftën Çlirimtare të Kosovës, veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ndahen në kategoritë si në vijim:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.1. Veteran Invalid i luftës së UÇK-së;</li> <li>1.2. Veteran Luftëtar i UÇK-së;</li> <li>1.3. Veteran i Internuar i UÇK-së;</li> <li>1.4. Veteran Ushtar i zhdukur (i pagjetur) i UÇK-së, dhe</li> <li>1.5. Veteran pjesëtarë i UÇK së.</li> <li>1.6. Veteran Pjesëmarrës i Luftës së</li> </ol>	<p>Government of Kosovo to all eligibly retired citizens, if defined and to the extent defined by legislation in force;</p> <p>1.18. <b>Law No. 04/L-054</b> - Law No. 04/L-054 on the Status and Rights of Martyrs, Invalids, Veterans, Members of Kosovo Liberation Army, Civilian Victims and their Families (Official Gazette of the Republic of Kosovo/No. 30/31 December 2011, Prishtina).</p> <p><b>II. CATEGORIZATION OF THE VETERANS IN THE KOSOVO LIBERATION ARMY</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 4</b> <b>Categorization of the veterans in the Kosovo Liberation Army</b></p> <p>1. While highly valuing their sacrifice and suffering of the people of Kosovo, participants of the Kosovo Liberation War shall be divided into following categories:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.1. KLA War Invalid Veteran;</li> <li>1.2. KLA Warrior Veteran;</li> <li>1.3. Interned Veteran by KLA;</li> <li>1.4. Veteran Missing KLA soldier; and</li> <li>1.5. KLA member Veteran.</li> <li>1.6. Veteran KLA War Participants.</li> </ol>	<p>Kosova isplaçuje svim građanima koji ostvaruju pravo na penziju, ako je tako propisano i u visini koja se utvrđuje na osnovu važećih zakona;</p> <p>118. <b>Zakon br. 04/L-054</b> - Zakon br. 04/L-054 o statusu i pravima palih boraca, invalida i veterana učesnika Oslobođilačke vojske Kosova, civilnih žrtava i njihovih porodica (Službeni list Republike Kosovo / br. 30 / 31. decembar 2011. godine, Priština).</p> <p><b>II. KATEGORIZACIJA VETERANA OSLOBODILAČKE VOJSKE KOSOVA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 4</b> <b>Kategorizacija veterana Oslobođilačke Vojske Kosova</b></p> <p>1. Visoko ceneći žrtve i patnje kosovskog naroda, u Oslobođilačkoj borbi Kosova, veterani Oslobođilačke Vojske Kosova dele se u sledećim kategorije:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.1. Veran Invalid rata OVK;</li> <li>1.2. Ratni veteran OVK;</li> <li>1.3. Internirani veteran član OVK;</li> <li>1.4. Nestali vojnik OVK, i</li> <li>1.5. Veteran Član OVK.</li> <li>1.6. Veterana učesnik rata OVK-a</li> </ol>
---	--	---

<p>UÇK-së.</p> <p>2. Dëshmoret e Kombit dhe kategoritë e veteranëve të përcaktuara në pikën 1.1, 1.3 dhe 1.4, të paragrafit një (1) të këtij neni, trajtohen sipas Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 5</b> <b>Statusi i veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës</b></p> <p>Statusi i të gjitha kategorive të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, konstatohet nga Komisioni.</p> <p style="text-align: center;"><b>III. LISTAT E VETERANËVE TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b> <b>Shqyrtimi i aplikimeve</b></p> <p>1. Pas mbledhjes së aplikacioneve, të personave që kanë aplikuar për përfitimin e statusit të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Komisioni shqyrton aplikacionet dhe përpilon Listat fillestare të personave sipas kategorive përkatëse.</p>	<p>2. Martyrs of the Nation and categories of veterans defined in points 1.1, 1.3 and 1.4, of the present Article shall be covered by the Law No. 04/L-054 on the Status and Rights of Martyrs, Invalids, Veterans, Members of Kosovo Liberation Army, Civilian Victims and their Familie.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 5</b> <b>Status of the veterans in the Kosovo Liberation Army</b></p> <p>The status of all categories that have participated in the KLV shall be ascertained by the Commission.</p> <p style="text-align: center;"><b>III. LISTS OF KOSOVO LIBERATION ARMY VETERANS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 6</b> <b>Application Review</b></p> <p>1. Following the receipt of applications, the Commission shall review application of persons who have applied for benefits of Kosovo Liberation War veterans status, Commission shall review preliminary lists of persons divided into respective categories.</p>	<p>2. Pali borci nacije i kategorije veterana utvrđene pod tačkama 1.1, 1.3 i 1.4 iz stava jedan (1) ovog člana tretiraju se na osnovu Zakona br. 04/L054 o statusu i pravima palih boraca, invalida i veterana učesnika Oslobodilačke vojske Kosova, civilnih žrtava i njihovih porodica.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 5</b> <b>Status veterana Oslobodilačke Vojske Kosova</b></p> <p>Status lica iz svih kategorija koje su učestvovala u OVK utvrđuje Komisija.</p> <p style="text-align: center;"><b>III. SPISKOVI VETERANA OSLOBODILAČKE VOJSKE KOSOVA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 6</b> <b>Razmatranje zahteva</b></p> <p>1. Posle prikupljanja zahteva koje su podnela lica koja su se prijavila za dobijanje statusa veterana Oslobodilačke vojske Kosova OVK, Komisija razmatra zahteve i sačinjava inicijalne spiskove lica iz odnosnih kategorija.</p>
---	---	---



<p>2. Komisioni bën publike Listat fillestare sipas kategorive përkatëse.</p> <p>3. Listat fillestare mbesin publike 30 ditë dhe publikohen në ueb faqen e ZÇKL-së dhe në së paku dy nga mediet si dhe në të gjitha degët e OVL-së, SHFD dhe SHIL.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 7 Ankesa</b></p> <p>1. Brenda periudhës prej 30 ditësh, që nga shpallja publike e Listave fillestare të kategorive të dala nga Lufta e UÇK-së, çdo aplikues, që ka prova të reja apo mendon se i është bërë e padrejtë, mund t'i drejtohet Komisionit për rishqyrtimin e kërkesës.</p> <p>2. Brenda periudhës prej 30 ditësh, që nga shpallja publike e Listave fillestare të kategorive të dala nga Lufta e UÇK-së, çdo qytetarë ka të drejtë që të paraqesë ankesë apo fakte lidhur me personat që janë apo që nuk duhet të jenë në Listën fillestare të kategorive të dala nga Lufta e UÇK-së.</p> <p>3. Rishqyrtimi i kërkesës së aplikuesve dhe ankesës së qytetarëve bëhet sipas procedurave të përcaktuara për vendimmarrje të Komisionit.</p>	<p>2. Commission shall make public the preliminary lists according to the respective categories.</p> <p>3. Preliminary lists shall be kept public for 30 days and published in the OACW webpage and at minimum two media outlets as well as throughout the branches of OWV, AFM and AWI.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 7 Appeals</b></p> <p>1. Any applicant in possession of new evidence or who believes that he/she was treated unfairly may appeal before the Commission on Review of Applications, within 30 days from the day the preliminary lists of categories deriving from the KLA War were made public.</p> <p>2. Any citizen shall be entitled to file an appeal or present evidence with regard to persons who are included or who should not be included in the preliminary lists of categories deriving from the KLA War within 30 days from the day preliminary lists of categories deriving from the KLA War were made public.</p> <p>3. Review of applications and appeals submitted by citizens shall be made on the basis of its envisaged decision-making procedures.</p>	<p>2. Komisija objavljuje početne spiskove prema odgovarajućim kategorijama.</p> <p>3. Inicijalni spiskovi ostaju objavljeni 30 dana a objavljuju se na internet stranici KPKR, u najmanje dva javna medija i u svim podružnicama ORV, UPPB i URI.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 7 Žalbe</b></p> <p>1. U roku od 30 dana od javnog objavljivanja inicijalnih spiskova kategorija proisteklih iz borbe OVK, svaki podnosilac prijave koji ima nove dokaze ili smatra da mu je učinjena nepravda, može da se obrati Komisiji za ponovno razmatranje zahteva.</p> <p>2. U roku od 30 dana od javnog objavljivanja inicijalnih spiskova kategorija proisteklih iz borbe OVK, svaki građanin ima pravo da podnese žalbu ili prijavi činjenice koje se odnose na lica koja jesu uvrštena ili koja ne treba da budu uvrštena u inicijalne spiskove kategorija proisteklih iz borbe OVK.</p> <p>3. Razmatranje zahteva podnosioca prijava i žalbi građana vrši se prema procedurama utvrđenim za odlučivanje Komisije.</p>
---	---	---

<p>4. Vendimi i Komisionit është përfundimtar në procedurë administrative;</p> <p>5. Kundër Vendimit të Komisionit pala e pakënaqur ka të drejtë që të iniciojë procedurën në Gjykatën kompetente.</p>	<p>4. The Commission's decision is final in the administrative procedure;</p> <p>5. Unsatisfied parties are entitled to initiate the procedure to the competent Court against Commission decisions.</p>	<p>4. Odlukakomisje je konačna u upravnom postupku</p> <p>5. Nezadovoljna strana ima pravo da pokreće postupak u nadležnom sudu.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 8</b> <b>Listat përfundimtare</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 8</b> <b>Final Lists</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 8</b> <b>Konačni spiskovi</b></p>
<p>1. Pas përfundimit të afatit të publikimit dhe shqyrtimit të ankesave, Komisioni miraton Listat përfundimtare të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.</p> <p>2. Duke u bazuar në Listat përfundimtare të të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, lëshon certifikatat për kategoritë përkatëse.</p> <p>3. Certifikata përmban të dhëna që mundësojnë identifikimin e qartë të kategorive të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.</p> <p>4. Dukja, forma dhe përmbajtja e certifikatave si dhe autoriteti përkatës që i lëshon ato, përcaktohet sipas aktit përkatës nënligjor të miratuar nga Qeveria.</p>	<p>1. Once the timeline for publication and review of appeals is over, the Commission shall approve final Lists of Kosovo Liberation Army Veterans.</p> <p>2. The Commission shall issue certificates for respective categories on the basis of final Lists of Kosovo Liberation Army Veterans.</p> <p>3. Certificate shall include data enabling the clear identification of categories of Kosovo Liberation Army Veterans.</p> <p>4. Outlook, form and content of the certificate as well as the respective issuing authority shall be defined with secondary legislation approved by the Government.</p>	<p>1. Po isteku roka za objavljivanje spiskova i razmatranje pritužbi, Komisija usvaja Konačne spiskove veterana Oslobodilačke vojske Kosova</p> <p>2. Na osnovu Konačnih spiskova veterana Oslobodilačke vojske Kosova , Komisija izdaje potvrde za odnosne kategorije.</p> <p>3. Potvrda sadrži podatke koji omogućavaju jasno utvrđivanje kategorije veterana Oslobodilake vojske Kosova.</p> <p>4. Izgled, oblik i sadržina potvrda kao i odnosni organi koji ih izdaju utvrđuju se na osnovu odgovarajućeg podzakonskog akta koji donese Vlada.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b> <b>Regjistrat</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 9</b> <b>Registers</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 9</b> <b>Registri</b></p>
<p>Duke u bazuar në Listat përfundimtare të</p>	<p>OACW shall maintain and update the registers</p>	<p>Na osnovu Konačnih spiskova kategorija</p>

<p>kategorive të dala të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,, ZÇKL-së krijon, mban dhe përditëson Regjistrat e kategorive përkatëse.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 10</b> <b>Pajisja me dokumente përkatëse</b></p> <p>1. Duke u bazuar në Listat përfundimtare të kategorive të dala nga LÇK, ZÇKL lëshon Vërtetime përkatëse për personat e kategorive të përcaktuara në këtë ligj.</p> <p>1. Duke u bazuar në vërtetimet e lëshuara nga ZÇKL, SHFD, OVL dhe SHIL lëshojnë Kartelat identifikuese sipas kategorive përkatëse.</p> <p>3. SHFD, OVL dhe SHIL i dorëzojnë ZÇKL-së Listën e personave që janë përfitues të kartelave identifikuese.</p> <p>4. Kartelat identifikuese sipas kategorive përkatëse, të përcaktuara në këtë ligj, duhet të jenë të sigurisë së lartë dhe të përmbajnë identitetin e plotë dhe fotografinë.</p> <p>5. Forma dhe përmbajtja e Librezës, përcaktohet sipas aktit përkatës nënligjor të miratuar nga Qeveria.</p>	<p>of respective categories on the basis of the final Lists of categories deriving from Kosovo Liberation Army veterans.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 10</b> <b>Provision of Respective Documents</b></p> <p>1. OACW shall issue respective Certificates for categories of persons defined by the present Law on the basis of the final Lists of categories deriving from KLW.</p> <p>2. AFM, OWV and AWI shall issue identification cards to respective categories on the basis of certificates issued by the OACW.</p> <p>3. AFM, OWV and AWI shall submit to OACW the list of persons entitled to receive identification cards.</p> <p>4. Identification cards for respective categories, defined by the present Law, shall include high security features and the full identity and picture of the person.</p> <p>5. Form and content of the Card Book shall be defined by respective secondary legislation approved by the Government.</p>	<p>proisteklih iz Oslobođilačke Vojske Kosva , KPKR ustanovljava, vodi i ažurira registre za odnosne kategorije.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 10</b> <b>Izdavanje odgovarajućih dokumenata</b></p> <p>1. Na osnovu Konačnih spiskova kategorija proisteklih iz OBK, KPKR izdaje shodna uverenja licima iz kategorija utvrđenih ovim Zakonom.</p> <p>2. Na osnovu uverenja koje izdaje KPKR, identifikacione kartice izdaju UPPB, ORV i URI u skladu sa odnosnom kategorijom.</p> <p>3. UPPB, ORV i URI dostavljaju KPKR spiskove lica koji su nosioci identifikacionih kartica.</p> <p>4. Identifikacione kartice za odnosne kategorije utvrđene ovim Zakonom moraju da budu obezbeđene visokom zaštitom i da sadrže pun identitet i fotografiju.</p> <p>5. Oblik i sadržina knjižice utvrđuju se na osnovu odgovarajućeg podzakonskog akta koji donese Vlada.</p>
--	--	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 11</b> <b>Familja e veteranit</b></p> <p>1. Me vdekjen e veteranit Familjes i jepet një dokument që vërteton se është familje veterani - Dekoraten: Familje Veterani.</p> <p>2. Dekorata: Familje Veterani, lëshohet nga Zyra.</p> <p>3. Familjet e veteranëve që kanë ndërruar jetë para hyrjes në fuqi të këtij ligji pajisen me Dekoraten: Familje Veterani.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 11</b> <b>Veteran's Family</b></p> <p>1. When a Veteran passes away, his/her Family shall be provided with a document proving the status of the Veteran's family: Decoration: Veteran's Family.</p> <p>2. Decoration: Veteran's Family shall be issued by the Office.</p> <p>3. Families of Veterans, who passed away, prior to entry into force of the present Law, shall be provided with the Decoration: Veteran's Family.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 11</b> <b>Porodica veterana</b></p> <p>1. Posle smrti veterana porodici se izdaje dokument kojim se potvrđuje da je to porodica veterana - Orden: Porodica veterana.</p> <p>2. Orden: Porodica veterana, izdaje Kancelarija.</p> <p>3. Porodicama veterana koji su umrli pre stupanja na snagu ovog Zakona izdaje se Orden: Porodica veterana.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 12</b> <b>Dokumentacioni i Komisioni</b></p> <p>1. Pas përfundimit të punës i gjithë dokumentacioni i Komisionit i dorëzohet ZÇKL-së.</p> <p>2. Dokumentacioni i Komisioni trajtohet dokument i klasifikuar sipas legjislacionit në fuqi për klasifikimin e informatave dhe Ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 12</b> <b>Commission's Documentation</b></p> <p>1. Once work is completed, the entire Commission's documentation shall be handed over to the OAWC.</p> <p>2. Commission's documentation shall be treated as a classified documentation according to legislation in force on classification of information and the Law on Protection of Personal Data.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 12</b> <b>Dokumentacija Komisije</b></p> <p>1. Po završetku rada, kompletna dokumentacija Komisije dostavlja se KPKR.</p> <p>2. Dokumentacija Komisije tretira se kao kalsifikovani dokument u skladu sa važećim zakonima koji propisuju klasifikaciju informacija i onim koji propisuju zaštitu ličnih podataka.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 13</b> <b>Deklarata e rreme dhe falsifikimi i dokumenteve</b></p> <p>Çdo person, i cili me vetëdije, paraqet</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 13</b> <b>False Statement and Documents' Forgery</b></p> <p>Any person who, intentionally, presents a false</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 13.</b> <b>Lažne izjave i falsifikovanje dokumenata</b></p> <p>Svako lice koje svesno daje netačne izjave</p>

<p>deklaratë jo të vërtetë (të rreme) apo prezanton dokumente të falsifikuara, me qëllim të përfitimit të statusit të pjesëmarrësit të LÇK-së dhe të përfitimit të të drejtave dhe beneficioneve, të përcaktuara sipas këtij ligji, ndëshkohet sipas ligjeve në fuqi lidhur me paraqitjen e deklaratës së rreme dhe falsifikim të dokumenteve.</p> <p style="text-align: center;"><b>IV. TË DREJTAT NË BENIFICIONE PËR VETERANËT LUFTËTAR TË UÇK-së</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 14 Dita e Veteranit</b></p> <p>Dita e Veteranit shënohet me 30 dhjetor, për të përkujtuar sakrificën, angazhimin dhe kontributin e veteranëve për sjelljen e lirisë dhe pavarësisë për popullin e Kosovës.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 15 Realizimi i të drejtës në pension dhe beneficione</b></p> <p>Veterani Luftëtar i UÇK-së, përmes njohjes së të drejtës në pension dhe beneficione të ndryshme i sigurohet mbështetje financiare dhe benefite të caktuara për kontributin e dhënë në luftën e UÇK-së.</p>	<p>statement or presents forged documents for the purpose of obtaining the status of KLA participant and benefiting from entitlements and benefits defined by the present Law, shall be sanctioned in accordance with the laws in force against presentation of false statement and documents' forgery.</p> <p style="text-align: center;"><b>IV. BENEFIT ENTITLEMENTS FOR KLA WARRIOR VETERANS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 14 Veteran's Day</b></p> <p>Veteran's Day shall be marked on every 30 December in order to remind us of the sacrifice, commitment and contribution of Veterans in bringing freedom and independence to the people of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 15 Enjoying the Entitlement to Pension and Benefits</b></p> <p>KLA Warrior Veteran, upon the recognition of the entitlement to pension and various benefits, shall be provided with financial support and certain benefits for his/her contribution in the KLA War.</p>	<p>(lažne) ili podnese falsifikovane dokumente u cilju sticanja statusa učesnika OVK i ostvarenja prava i dobijanja beneficija utvrđenih ovim Zakonom, biće kažnjeno u skladu sa važećim zakonima za davanje lažnih izjava i podnošenje falsifikovanih dokumenata.</p> <p style="text-align: center;"><b>IV. PRAVA NA BENEFICIJE RATNIM VETERANIMA OVK</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 14 Dan veterana</b></p> <p>Dan veterana obeležava se 30. decembra, u znak pomena na žrtve, angazovanje i doprinos veterana za donošenje slobode i nezavisnosti narodu Kosova.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 15. Ostvarenje prava na penziju i beneficije</b></p> <p>Ratni veteran OVK kroz priznavanja prava na penziju i na razne beneficije ostvaruje finansijsku podršku propisanu za doprinos dat borbi OVK.</p>
---	--	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 16</b> <b>Pensionin personal i veteranit</b></p> <p>1. Veterani Luftëtar i UÇK-së realizon Pensionin personal të veteranit sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.</p> <p>2. Veterani Luftëtar i UÇK-së nuk mund të jetë shfrytëzues i asnjë pensioni nga skemat e tjera pensionale të financuara nga shteti. Nëse Veterani luftëtar është shfrytëzues i ndonjë skeme personale të financuar nga shteti në Republikën e Kosovës duhet të përcaktohet se cilin pension do të marrë.</p> <p>3. Veterani Luftëtar i UÇK-së i cili merr pension të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, sipas Ligjit nr. 03/L-100 për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, (Gazeta Zyrtare, nr. 41 / 01 nëntor 2008), duhet të përcaktohen se cilin pension do të marrin.</p> <p>4. Veteranët e UÇK-së të cilët janë të punësuar në sektorin publik dhe privat nuk kanë të drejtë të përfitimit të pensionit.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 16</b> <b>Veteran's Personal Pension</b></p> <p>1. KLA Warrior Veteran shall enjoy a Veteran's Personal Pension on the basis of conditions defined in the present Law.</p> <p>2. KLA Warrior Veteran may not benefit from any other pension from the set of state-funded pension schemes. If the Warrior Veteran benefits from any other pension scheme funded by the Republic of Kosovo, he/she shall decide on one of the pension benefits he/she wishes to receive.</p> <p>3. KLA Warrior Veteran, receiving the pension of the Kosovo Protection Corps, pursuant to the Law No. 03/L-100 on Pensions for Members of the Kosovo Protection Corps (Official Gazette, No. 41 / 1 November 2008), shall decide on one of the pension benefits he/she wishes to receive.</p> <p>4. KLA Veterans employed in the public or private sector shall not be entitled to pension benefits.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 16</b> <b>Lična penzija veterana</b></p> <p>1. Ratni veteran OVK ostvaruje pravo na ličnu penziju veterana na osnovu uslova utvrđenih u ovom Zakonu.</p> <p>2. Ratni veteran OVK ne može da bude primalac nikakve druge penzije niti drugog penzionog plana koji finansira država. Ako je ratni veteran korisnik bilo kakvog drugog penzionog plana koji finansira država u Republici Kosovo, mora da se opredeli za penziju koju želi da prima.</p> <p>3. Ratni veteran OVK koji prima penziju od Kosovskih zaštitnih snaga na osnovu Zakona br. 03/L-100 o penzijama učesnika Kosovskih zaštitnih snaga (Službeni glasnik, br. 41 / 01. novembar 2008), mora da se opredeli za penziju koju želi da prima.</p> <p>4. Veterani OVK koji su zaposleni u javnom i privatnom sektoru nemaju pravo na penziju.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 17</b> <b>Shtesa në Pensionin e pleqërisë</b></p> <p>Veterani Luftëtar i UÇK-së i punësuar në sektorin publik dhe privat pas arritjes së</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 17</b> <b>Supplement to the Elderly Pension</b></p> <p>KLA Warrior Veteran, employed in the public or private sector, after reaching the legally</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 17</b> <b>Dodatak na starosnu penziju</b></p> <p>Ratni veteran OVK zaposlen u javnom i privatnom sektoru posle navršetka zakonom</p>

<p>moshës ligjore të pensionimit ka të drejtë në shtesë të pensionit për barazim me pensionin e veteranit luftëtar.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 18</b> <b>Lartësia e shumës së pensioneve</b></p> <p>Varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual, në fund të çdo viti për vitin e ardhshëm, Qeveria e Kosovës me propozimin e Ministrisë së Financave me vendim të veçantë, mund të vendosë për lartësinë e shumës së pensionit të Veteranit Luftëtar të UÇK-së, cila nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale e përcaktuar në Kosovë.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 19</b> <b>Parashtrimi i kërkesës për pension</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kërkesën për Pension të Veteranit Luftëtar i UÇK-së, mund ta parashtrij veterani, personi i autorizuar nga ai ose trashëgimtari(ët) pas vdekjes së veteranit.</li> <li>2. Për realizimin e së drejtës në pension, sipas dispozitave të këtij ligji, aplikuesi e paraqet kërkesën në Zyrën Rajonale të Departamentit të Ministrisë për Familjet e Dëshmorëve, Invalidët e Luftës dhe viktimat civile të luftës.</li> </ol>	<p>prescribed age for retirement shall be entitled to a pension supplement equal to the pension of the Warrior Veteran.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 18</b> <b>Pension Level</b></p> <p>Depending on budget affordability, living costs and possible inflation, at the end of each year, the Government of Kosovo, following the proposal of the Ministry of Finance, with a special decision may decide on the level of pension for KLA Warrior Veterans for the coming year, which may not be lower than the minimum wage in Kosovo.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 19</b> <b>Application for Pension</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Application for KLA Warrior Veteran Pension may be submitted by the Veteran, an authorized pension by him/her or his/her inheritor(s) if the Veteran has passed away.</li> <li>2. For the purpose of enjoying the entitlement to pension pursuant to the provisions of the present Law, the applicant shall submit the request to the Regional Office of the Ministry Department on Families of Martyrs, War Invalids and Civilian Victims of War.</li> </ol>	<p>propisanih godina života za penzionisanje ima pravo na dodatak na penziju radi ujednačavanja sa penzijom ratnog veterana.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 18</b> <b>Iznos penzije</b></p> <p>U zavisnosti od budžetskih mogućnosti, troškova života i moguće inflacije, Vlada Kosova na predlog Ministarstva finansija svojom posebnom odlukom može da na kraju svake godine za narednu godinu utvrdi visinu iznosa penzije za ratne veterane OVK, koji ne može da bude niži od iznosa minimalne zarade utvrđene na Kosovu.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 19</b> <b>Podnošenje zahteva za penziju</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Zahtev za dobijanje penzije ratnog veterana OVK mogu da podnesu veteran, lice koje on ovlasti ili naslednik (naslednici) posle smrti veterana.</li> <li>2. Za ostvarenje prava na penziju, u skladu sa odredbama ovog Zakona, podnosilac zahteva podnosi takav zahtev u regionalnoj kancelariji Odeljenja za porodice palih boraca, invalide rata i civilne žrtve rata pri Ministarstvu.</li> </ol>
--	---	--

